

VENDIM
Nr. 3, datë 25.5.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji i Posaçëm i Apelit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	kryetar;
Natasha Mulaj	anëtare;
Ina Rama	anëtare;
Rezarta Schuetz	anëtare;
Mimoza Tasi	anëtare;
Albana Shtylla	anëtare,

- mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, në datën 25.5.2026, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdi, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 3/2025, datë 3.11.2025, që i përket:

ANKUESE: Ajshe Xhafa, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë Gjyqësor;

Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 190, datë 2.4.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor për caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

BAZA LIGJORE: Neni 140 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 147, pika 1 e Kushtetutës; neni 147/d i Kushtetutës; neni 179, pika 7 e Kushtetutës; neni 100, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 101, pika 1, e ligjit nr. 96/2016; neni 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016; neni 105, pika 1, e ligjit nr. 96/2016; neni 107, i ligjit nr. 96/2016; neni 115, i ligjit nr. 96/2016; neni 138, i ligjit nr. 96/2016; neni 146, i ligjit nr. 96/2016; neni 147, i ligjit nr. 96/2016; neni 148, i ligjit nr. 96/2016; neni 149, i ligjit nr. 96/2016; neni 86, i ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; neni 97, i ligjit nr. 115/2016; neni 98, i ligjit nr. 115/2016; neni 100, i ligjit nr. 115/2016; neni 4, i ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; neni 5, i ligjit nr. 98/2016.

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT,

pasi shqyrtoi pretendimet e ankueses Ajshe Xhafa, e cila ka kërkuar pranimin e ankimit, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që kanë kërkuar rrëzimin e ankimit, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Ankuesja Ajshe Xhafa (në vijim “ankuesja” dhe/ose “magjistratja”) ushtron detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, e caktuar në këtë pozicion me vendimin nr. 631, datë 19.10.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Në referim të shpjegimeve dhe të akteve në dosje, ankuesja ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen penale me nr. {***}. Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, me objekt “Kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {***}/2022”, për të cilën, pasi është zhvilluar një seancë gjyqësore¹, në seancën e radhës² është paraqitur kërkesa për gjykim të shkurtuar dhe, si rrjedhim, kjo seancë është shtyrë me qëllim formimin e trupit gjykues, i cili është formuar me kryesuese gjyqtaren E. F. dhe anëtarë gjyqtaret Ajshe Xhafa dhe S. K.³, të cilat kanë marrë dijeni se seanca e radhës do të zhvillohej në datën 11.9.2024.

3. Në seancën gjyqësore të datës 11.9.2024, anëtarja e trupit gjykues, magjistratja Ajshe Xhafa, përveç kërkesës për shtyrje të seancës, me arsyen se nuk është njohur me aktet e dosjes, duke kërkuar kohë për t’u njohur dhe për t’u shprehur, në lidhje me kërkesën për gjykim të shkurtuar, ka relatuar, ndër të tjera⁴, si vijon.

“3.1 [...] është hera e dytë që qoftë gjyqtare S. K. dhe kryesuesja e trupit gjykues nuk më vënë në dispozicion dhe krijojnë pengesa në lidhje me studimin e dosjeve, përkatësisht e njëjta situatë ka qenë në çështjen penale me të pandehur E. M., e njëjta situatë edhe me këtë çështje penale, unë nuk jam njohur me dosjen, nuk e ka pasur asnjëherë dosjen dhe, për këto arsye, për t’u shprehur lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar kërkoj kohën e mjaftueshme[...].”

3.2 [...] Më duket totalisht e pavend dhe e papranueshme që dhe në seancën e kaluar në një çështje penale me ju të dyja anëtare të trupit gjykues, kërkonin dhe nxirrni pengesa të tilla ndaj meje si anëtare e trupit gjykues, kjo bëhet nga të dyja gjyqtaret S. K. dhe E. F., dhe kjo është bërë edhe në këtë seancë gjyqësore dhe unë mendoj që pretendime dhe sjellje të tilla të të dyjave anëtareve të trupit gjykues janë në mënyrë tendencioze dhe të qëllimshme për të më penguar mua si anëtare e trupit gjykues, për të pasur kohën e nevojshme për t’u njohur me dosjen në fjalë [...].”

3.3 Pas fjalës së kryetares së trupit gjykues⁵, magjistratja Ajshe Xhafa ka vijuar me relatimin në seancë gjyqësore: “Pretendime të tilla, siç edhe kryetarja e trupit gjykues i konstatoi, janë të pabazuara dhe janë të papranueshme për t’u zhvilluar në një seancë gjyqësore, nisur me sa u relatua nga ana e kryesueses së trupit gjykues. Në lidhje me procesverbalet, unë çmoj se duke qenë se kjo është çështje e cila po përsëritet, është përsëritur edhe në çështjen penale E. M., për të cilën të paktën nga disa palë pjesëmarrëse në proces është njoftuar Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili është duke inspektuar dosjen dhe do të inspektojë dosjet, unë çmoj si anëtare e trupit gjykues, duke qenë se nga ana e të dyjave anëtareve kjo është një situatë e cila ka filluar të bëhet e vazhdueshme, duke mos u vënë dosjet dhe fashikujt e prokurorisë në dispozicion në mënyrë të qëllimshme nga ana e të dyjave anëtarëve të trupit gjykues të njoftohet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli

¹ Seanca gjyqësore e datës 18.7.2025, cituar në raportin nr. {***} prot., datë 13.2.2025, të ILD-së.

² Seanca gjyqësore e datës 25.7.2025, cituar në raportin nr. {***} prot., datë 13.2.2025, të ILD-së.

³ Sipas shortit të organizuar në datën 29.7.2025, cituar në raportin nr. {***} prot., datë 13.2.2025, të ILD-së.

⁴ Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 11.9.2024, ora 11:04:03, cituar në raportin nr. {***} prot., datë 13.2.2025, të ILD-së.

⁵ Në lidhje me sa u pretendua nga gjyqtare Ajshe Xhafa, kryesuesja e trupit gjykues ka relatuar se, sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Penale, i është vënë në dispozicion në datën 29.7.2024, gjithë materiali i depozituar nga ana e prokurorisë, dosja në origjinal gjyqtarës Ajshe Xhafa dhe dorëzimi i është bërë nga sekretari gjyqësor F. Th., i cili ka mbajtur procesverbalin përkatës, për refuzimin e marrjes së dosjes nga gjyqtarja Ajshe Xhafa (lidhur me kohën që kërkon t’i vihet në dispozicion, çmoj të bazuar kërkesën për t’ia vënë në dispozicion aktet në origjinal gjyqtarës, për t’u njohur, t’i japë edhe kohën e mjaftueshme për t’u njohur dhe për t’u shprehur lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe nuk ka nevojë të vijojë debati në proces, pasi palët nuk interesohen për zgjidhjen e kësaj pjese administrative, interesohen për zgjidhjen e çështjes së tyre në themel).

i Lartë Gjyqësor në lidhje me sjelljet e të dyja anëtareve [...].”.

4. Seanca gjyqësore, në të cilën kanë qenë prezent përfaqësuesi i organit të akuzës dhe avokati mbrojtës është shtyrë për t'u zhvilluar në një datë tjetër, për dhënien e kohës gjyqtares Ajshe Xhafa të njihet me aktet e dosjes dhe, po atë ditë, kryesuesja e trupit gjykues, gjyqtarja E. F. ka kërkuar të diskutohet sjellja e gjyqtares Ajshe Xhafa në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve.

5. Me shkresën nr. {***} prot., datë 18.9.2024⁶, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka dërguar pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, procesverbalin e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve të datës 11.9.2024, në të cilin është diskutuar shqetësimi i ngritur nga gjyqtarja E. F., në lidhje me sjelljen e magjistrates Ajshe Xhafa gjatë zhvillimit të një seance gjyqësore⁷. Të njëjtin shqetësim ka ngritur edhe gjyqtarja S. K., e cila ka parashtruar se magjistratja Ajshe Xhafa ka pasur të njëjtën sjellje edhe me të, duke pretenduar fshehjen e fashikujve hetimorë në një çështje tjetër penale⁸.

6. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim “ILD”), me vendimin nr. 2448/2, datë 15.10.2024, ka vendosur fillimin e hetimit me iniciativë ndaj magjistratëve Ajshe Xhafa dhe S. K., me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 2, shkronja “dh” dhe neni 101, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

7. ILD-ja, me vendimin nr. 2448/32 prot., datë 14.2.2025, “Për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratëve Ajshe Xhafa dhe S. K., gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”, ka vendosur: “1. Përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistrates S. K. dhe Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 2, shkronjat “dh”, si dhe neni 101, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

[...] 3. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për shkelje disiplinore nga neni 102, pika 2, shkronja “dh”, si dhe neni 101, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Propozimin e masës disiplinore “Vërejtje publike”, të parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “b” dhe neni 107, i ligjit nr. 96/2016, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 2, shkronja “dh”, si dhe neni 101, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. [...]”.

8. Me shkresën nr. {***} prot., datë 14.2.2025, ILD-ja i ka njoftuar magjistrates Ajshe Xhafa vendimin nr. 2448/32 prot., datë 14.2.2025, “Për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratëve Ajshe Xhafa dhe S. K., gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”, si dhe raportin e hetimit disiplinor nr. {***} prot., datë 13.2.2025.

9. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka administruar shkresën e ILD-së me nr. {***} prot., datë 14.2.2025, me anë të së cilës është paraqitur kërkesa “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”, me propozimin për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje

⁶ Sipas raportit nr. {***} prot., datë 13.2.2025, të ILD-së “Për hetimin disiplinor me iniciativë, ndaj veprimtarisë së magjistratëve Ajshe Xhafa dhe S. K., me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”.

⁷ Çështja penale me nr. {***}, me objekt “Kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {***}/2022”.

⁸ Çështja penale me nr. {***}, me objekt “Kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {***}/2022”.

publike”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “b” dhe neni 107, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”), shoqëruar me raportin për hetimin disiplinor nr. {***} prot., datë 13.2.2025, dhe dosjen hetimore për zhvillimin e procedurës disiplinore në ngarkim të kësaj magjistrateje.

10. Magjistratja Ajshe Xhafa dhe ILD-ja janë vënë në dijeni me shkresën e KLGj-së nr. {***} prot., datë 4.3.2025, për vendimin nr. 120, datë 27.2.2025, të KLGj-së “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”, në datën 18.3.2025. Magjistratja Ajshe Xhafa ka depozituar në KLGj parashtrimet e saj me shkrim, lidhur me fillimin e procedimit disiplinor ndaj saj në datën 17.3.2025.

11. KLGj-ja, pas zhvillimit të seancës dëgjimore, me vendimin nr. 190, datë 2.4.2025, ka vendosur pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, vendim i cili i është komunikuar me shkresën nr. {***} prot., datë 1.7.2025.

12. Kundër vendimit të mësipërm të KLGj-së, ka ushtruar ankim magjistratja Ajshe Xhafa, duke kërkuar: i. pranimin e ankimit; ii. shfuqizimin e vendimit nr. 190, datë 2.4.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor për caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës; dhe iii. në mënyrë alternative, nëse do të konstatohet përgjegjësi disiplinore, të zëvendësohet masa me një masë më të lehtë, edukative (vërejtje konfidenciale), ose të kthehet çështja për rishqyrtim për arsyetim dhe individualizëm të masës.

13. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak për çështjen nr. 3/2025 të Juridiksionit Disiplinor (JD), me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 190, datë 2.4.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”, ka vlerësuar se ankimi plotëson të gjitha kushtet për t’u gjykuar në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, si një ankim individual ndaj masës disiplinore të dhënë, në referim të nenit 5, pika 3, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 32, pika 1, e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar.

14. Me vendimin nr. 3/1, datë 3.2.2026, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, bazuar në nenin 21, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka vendosur: “*Kalimin për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve të çështjes (JD) nr. 3, datë 3.11.2025, që i përket ankimit të magjistrates Ajshe Xhafa, ndaj vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 190, datë 2.4.2025. [...]*”.

15. Kolegji, në kuadër të gjykimit në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve të çështjes (JD) nr. 3/2025, datë 3.11.2025, me ankuese Ajshe Xhafa, kërkoi prapësimet/parashtrimet nga subjektet e interesuara. Subjektet e interesuara, KLGj-ja dhe ILD-ja, kanë depozituar në Kolegj prapësimet e tyre⁹, respektivisht në datat 14.5.2026 dhe 18.5.2026, ndërsa në datën 15.5.2026, ka depozituar parashtrimet e saj edhe ankuesja, znj. Ajshe Xhafa¹⁰.

I. Pretendimet e magjistrates Ajshe Xhafa në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

⁹ Sipas shkresës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. {***} prot., datë 15.5.2026, protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 18.5.2026 dhe shkresës së Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. {***} prot., datë 12.5.2026, protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 13.5.2026.

¹⁰ Protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 15.5.2026.

16. Magjistratja Ajshe Xhafa, nëpërmjet ankimit të depozituar në Kolegj ndaj vendimit të KLGj-së nr. 190, datë 2.4.2025, për shfuqizimin e vendimit “Për caktimin e masës disiplinore ‘Vërejtje publike’” dhe parashtrimeve të paraqitura në Kolegj në datën 15.5.2026, parashtron në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

17. Ankuesja pretendon se, gjatë procedimit disiplinor të saj, organet disiplinore kanë cenuar parimet mbi të cilat udhëhiqen, pra e drejta për një proces të rregullt ligjor, prezumimi i pafajësisë, parimi i ligjshmërisë dhe dyshimi në favor të magjistratit. Sipas saj, para se të ndërhyhet në sferën profesionale dhe reputacionale, duhet të provohen me mjaftueshmëri fakte tipike dhe lidhja e tyre individuale me magjistratin, jo thjesht të konstatohet një klimë e paqartë tensionesh ose një rrezik i përgjithshëm përsëritjeje.

18. Shkeljet disiplinore të parashikuara në nenin 101, paragrafi 1 dhe neni 102, paragrafi 2, shkronja “dh”, u referohen sjelljeve që cenojnë rregullat e solemnitetit, si dhe marrëdhënieve me palët apo magjistratët në një shkallë që prek besimin në drejtësi. Episodi i seancës gjyqësore të datës 11.9.2024, lidhet drejtpërdrejt me një kërkesë procedurale për shtyrje dhe njohje efektive me aktet, pas pamundësisë objektive për t’u pajisur me kopje të akteve gjatë orarit, pa deklarime publike dhe pa tejçim jashtë sallës. Vendimmarrja unanime për gjykimin e shkurtuar dhe vendimin përfundimtar tregon se autoriteti kolegjal nuk u cenua në rezultat dhe se nuk u krijua ndikim i papranueshëm mbi paanësinë institucionale.

19. Neni 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016, kërkon plotësimin e dy elementeve kumulative: i. ekzistencën e një sjelljeje që cenon rregullat e sjelljes; dhe ii. që kjo sjellje të jetë “e përsëritur” ose “e rëndë”, që në rastin konkret nuk plotësohen asnjë nga dy alternativat. Episodi, i pretenduar, i seancës gjyqësore të datës 11.9.2024, është një ngjarje e vetme, e zhvilluar në harkun kohor prej tetë minutash¹¹ dhe nuk ka asnjë sjellje të ngjashme të provuar pas kësaj date. Shumësia e fjalëve të shqiptuara brenda së njëjtës seancë nuk përbën “përsëritje” në kuptim të shkronjës “dh”, pika 2, e nenit të sipërcituar.

20. Shkelja nuk është “e rëndë”, pasi edhe vetë KLGj-ja në parashtrime cilëson shkeljen si “shkelje e lehtë disiplinore”. Nëse shkelja është “e lehtë” dhe, gjithashtu, nuk është e përsëritur, atëherë nuk plotësohen asnjë nga dy alternativat e nenit 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016.

21. Aplikimi i nenit 101, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, lidhet drejtpërdrejt me një kërkesë procedurale për shtyrje dhe njohje efektive me aktet, pas pamundësisë objektive për t’u pajisur me kopje të akteve gjatë orarit, pa deklarime publike dhe pa tejçim jashtë sallës.

22. Elementi subjektiv nuk përmbushet në formën e dashjes direkte. Qëndrimi i magjistrates lidhet me nevojën reale për të siguruar njohje të plotë me fashikujt në një çështje voluminoze dhe me kompleksitet të veçantë teknik, dhe jo me synimin për të ulur figurën e kolegeve.

23. Nuk provohet ardhja e pasojave të dëmshme në proces, pasi trupa gjyqësore vijoi me gjykimin dhe me një vendimmarrje unanime. Seanca gjyqësore ishte publike vetëm në aspektin formal, pasi prezentë ishin vetëm përfaqësuesi i akuzës dhe avokati mbrojtës. Pra, nuk mund të flitet për diskreditim të gjykatës dhe as për cenim real të besimit të publikut në kuptim të Parimeve të Bangalores.

24. Kërkesa për kopje të thjeshta ose të njësuar është mjet i arsyeshëm organizativ për të garantuar integritetin e dosjes dhe gjurmueshmërinë jashtë orarit zyrtar, në përputhje me nenin 3, pika 5 dhe nenin 4, të ligjit nr. 96/2016, si dhe me parimet e integritetit, respektit dhe transparencës së Kodit të Etikës Gjyqësore. Shtyrja e seancës gjyqësore dhe riadministrimi i akteve nga trupa

¹¹ Sipas vendimit, ndërmjet orës 11:03 dhe 11:11.

gjykuese konfirmojnë se shqetësimi procedural ishte legjitim dhe duhej adresuar me masa organizative, jo me sanksionim.

25. Masa disiplinore “Vërejtje publike” nuk qëndron, sepse bazohet kryesisht në një procesverbal të njëanshëm të sekretarit gjyqësor¹², pa nënshkrimin e magjistrates dhe pa garanci kundërshtimi. Për shkak të afateve të ngushta të seancave gjyqësore që lidheshin me masa sigurimi, kërkesa për fotokopjim të fashikujve brenda ditës, ishte e arsyeshme dhe e zakonshme, ndaj moszbatimi për fotokopjim të fashikujve, nuk mund t’i atribuohet si sjellje disiplinore gjykatësës që kërkonte akses të ligjshëm në akte. Ndërsa citimet audio të seancës gjyqësore janë përdorur të fragmentuara, ndaj, në këto rrethana, parimi i ligjshmërisë dhe i dyshimit në favor të magjistratit gjatë procedurës disiplinore, kërkon mosvendosjen e një sanksioni publik.

26. Kërkesa për shtyrje, me qëllim njohjen me aktet e dosjes lidhej drejtpërdrejt me detyrimin funksional për të vendosur me një kërkesë sensitive si gjykimi i shkurtuar, pa asnjë dashje direkte për denigrim. Imuniteti funksional mbron shprehjet gjatë ushtrimit të detyrës, përveç rasteve të keqbesimit ose interesit vetjak, të paprovuara në dosje.

27. Përdorimi si rrethanë rënduese i një episodi nga një çështje tjetër tejkalon objektin e procedimit të njoftuar dhe cenon parimin e akuzës dhe së drejtës për mbrojtje. Pengesat objektive në qasjen ndaj fashikujve dhe vendimet për shtyrje e riadministrim, konfirmojnë se shqetësimi procedural ishte legjitim, jo denigruar.

28. Edhe nëse vlerësohet se gjuha e përdorur më datë 11.9.2024, meriton *vërejtje metodologjike*, proporcionaliteti nuk është arsyetuar. Rrethanat lehtësuese të nenit 115/3 (herë e parë, ndikim i kufizuar të rrethi i ngushtë i palëve, bashkëpunim i plotë procedural, përvojë e kufizuar, mungesë dëmi material në proces dhe vendimmarrje unanime) imponojmë masa më të lehta sesa “Vërejtje publike” (neni 107, i ligjit nr. 96/2016), ndërsa mungesa e një analize të plotë të kriterëve cenon standardin e arsyetimit të vendimit (neni 146, i ligjit nr. 96/2016).

29. Parimi i proporcionalitetit kërkon që masa të jetë e përshtatshme, e domosdoshme dhe e balancuar. Edhe sikur të pranohej se toni i komunikimit në atë seancë gjyqësore meriton *vërejtje metodologjike*, rrethanat lehtësuese janë të shumta sipas nenit 115, pika 3, përfshirë faktin se kemi shkelje për herë të parë, ndikim të kufizuar, bashkëpunim të plotë dhe përvojë të kufizuar kolegjiale gjatë vitit të parë në detyrë. Qëllimi edukativ dhe parandalues arrihet me mjete më pak stigmatizuese, si këshillimi etik ose vërejtja konfidenciale, jo me vërejtje publike që prek disproporcionalisht reputacionin profesional.

30. Vendimi i KLGj-së nuk plotëson standardin e vendimit të arsyetuar në mënyrë të plotë, të individualizuar dhe të mbështetur në prova konkrete. Motivimi i vendimit duhet të jetë i individualizuar dhe i mbështetur në prova të verifikueshme. Formula të përgjithshme, si: marrëdhënie jo të normalizuara ose rrezik përsëritjeje, pa identifikuar ngjarje konkrete para datës 11 shtator 2024 dhe pa peshuar kundërproven mbi qasjen në dosje, nuk përmbushin kërkesat e nenit 146 dhe nenit 115, pika 2, e ligjit nr. 96/2016. Parimi i barazisë para ligjit kërkon, gjithashtu, konsistencë sanksionesh në raste analoge, gjë që nuk del e argumentuar.

31. Masa e “Vërejtjes publike” rezulton jo e nevojshme dhe joproporcionale dhe e pajustifikuar edhe në këndvështrimin e praktikës së GjEDNj-së¹³. Në përfundim, në mungesë të provës së

¹² *Procesverbali i nënshkruar vetëm nga sekretari gjyqësor, ka vlerë të kufizuar provuese për të provuar një refuzim me dashje (sipas këtij procesverbali, sekretari gjyqësor z. F. Th. ka ardhur në zyrën e magjistrates për të dorëzuar fizikisht dosjen origjinale dhe se është refuzuar marrja fizike e dosjeve prej magjistrates, duke i kërkuar që të vihen në dispozicion kopje të njësuara me origjinalin, si anëtare e trupit gjykues me të drejtën për t’u njohur me dosjen).*

¹³ *Wille kundër Libtebshtajnit (aplikimi nr. 28396/95, 28.10.2.1999, Dhoma e Madhe); Kudeshkina kundër Rusisë*

mjaftueshme për elementet tipike të neneve 101, paragrafi 1 dhe 102, paragrafi 2, shkronja “dh”, në prani të rrethanave të qarta lehtësuese dhe pa pasoja reale në proces, kërkohet rrëzimi i saj dhe në subsidiaritet, vetëm nëse çmohet ndërhyrje edukative, zëvendësimi me një mjet më të butë dhe urdhërimi i masave organizative që standardizojnë qasjen në dosje në mënyrë që situata të ngjashme të mos përsëriten.

II. Prapësimet e KLGj-së, lidhur me pretendimet e magjistrates Ajshe Xhafa

32. Sipas KLGj-së, pretendimi i ankueses se gjatë procedimit disiplinor të saj, organet disiplinore kane cenuar parimet mbi të cilat udhëhiqen, pra e drejta për një proces të rregullt ligjor, prezumimi i pafajësisë, parimi i ligjshmërisë dhe dyshimi në favor të magjistratit, nuk qëndron. KLGj-ja ka respektuar parimet e sanksionuara në nenin 100, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, si dhe ka marrë parasysh veçanërisht faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe figura e magjistratit nga akuzat e pabaza dhe rëndësinë që ka informimi i publikut, në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë.

33. Nga shqyrtimi i procedimit disiplinor, rezultoi e provuar se magjistratja, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, ka kryer shkelje disiplinore të parashikuara në nenin 101, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016, duke shkelur rregullat e sjelljes me magjistratët e tjerë gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore publike të datës 11.9.2024, ku palë të pranishme kanë qenë përfaqësuesi i organit të akuzës dhe mbrojtësi i të pandehurit.

34. Magjistratja Ajshe Xhafa, me sjelljen e saj, jo vetëm që ka vënë në dyshim integritetin e gjykatës, në lidhje me çështjen objekt gjykimi, por ka vënë në dyshim para palëve pjesëmarrëse dhe integritetin e gjykatës, në lidhje me një çështje tjetër, e cila nuk ka pasur lidhje me çështjen objekt gjykimi, gjykimi i së cilës kishte përfunduar kohë më parë, nga i njëjti trup gjykues.

35. Sjellja dhe retorika që magjistratja ka përdorur në sallë të gjyqit, në seancën e datës 11.9.2024, në mënyrë të përsëritur, tregon se nuk e ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në vetëpërmbytje, maturi dhe kujdesin e duhur që duhet të karakterizojë një magjistrat gjatë ushtrimit të detyrës, duke shkelur, pra duke mos respektuar vlerat themelore të përcaktuara në nenet 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2016. Sjellja e saj në seancën gjyqësore publike nuk justifikohet edhe nëse e ka pasur të pamundur objektivisht njohjen me aktet e dosjes, apo nuk do t'i ishte vënë në dispozicion dosja për njohje.

36. Magjistratja nuk ka treguar kujdesin e duhur për të ruajtur standardin e gjyqtarës së përgjegjshme dhe profesionale, edhe pse ka pasur mundësitë të bënte një sjellje dinjitoze, për të mos cenuar integritetin e gjykatës, duke shkelur rëndë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes që duhet të karakterizojnë një gjyqtare, duke përdorur më shumë se një herë, një retorikë të papërshtatshme në raport me funksionin e gjyqtarit, ndërsa ka qenë duke gjykuar në seancë gjyqësore me dyer të hapura, në prani të palëve, sjellje kjo e cila cenon integritetin dhe ul reputacionin e gjykatës. Qëndrimi i saj, shfaqur në seancën gjyqësore të datës 11.9.2024, përbën rrezik që të përçojë te palët përshtypjen se gjykata, dy gjyqtarët e tjerë, është duke ndërmarrë një qasje të njëanshme dhe që palët humbasin besimin në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

37. Magjistratja Ajshe Xhafa ka konsumuar elementet e shkeljes disiplinore që ka të bëjë me sjelljen joetike të parashikuar në nenin 101, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016.

38. KLGj-ja, në caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore dhe llojit të masës disiplinore, ka marrë parasysh kriteret e parashikuara në nenin 115, pika 1, e ligjit nr. 96/2016.

39. Lidhur me llojin dhe rrethanat e shkeljes, rezulton se magjistratja Ajshe Xhafa, subjekt procedimi disiplinor, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, ka shkelur rregullat e sjelljes me

magjistratët e tjerë pjesë e trupit gjykues, gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore të datës 11.9.2024. Shkeljet e konstatuara, për shkak të rëndësisë së tyre, nuk lidhen me veprimtarinë profesionale të një gjyqtari, por janë të natyrës që magjistrati duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore.

40. Duke analizuar shkallën e fajësisë dhe motivin, rezulton se shkelja disiplinore nga ana e magjistrates është kryer me dashje direkte, vërtetuar kjo edhe me deklaratimet e dhëna nga vetë ajo gjatë zhvillimit të hetimit disiplinor, sikurse rezultoi edhe gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor në Këshill.

41. Sa u përket pasojave të shkeljes, sjellja e magjistratit dhe në veçanti e një gjyqtareje në sallën e gjyqit nuk është e rëndësishme vetëm në kontekstin profesional. Në respektim të parimeve të *Bangalores* për sjelljen në gjyqësor, cenimi edhe vetëm i parimeve të etikës, në marrëdhëniet e punës apo edhe jashtë saj, mund të përbëjë shkak për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Sjellje të caktuara të magjistratit, aq më tepër kur kjo sjellje cenon paanësinë e dy kolegeve të saj pjesë e trupit gjykues në prani të palëve, konsiderohet si cenim i parimit të besimit të palëve të pranishme te drejtësia, si dhe diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit, duke cenuar dhe integritetin e reputacionin e gjykatës.

42. Sipas KLGj-së, ekziston ende rreziku për të ndodhur ngjarje të cilat dëmtojnë imazhin e gjykatës, pasi gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor në Këshill, sipas deklaratimit të vetë magjistrates, marrëdhënia e saj me dy kolegët vazhdon të mos jetë e normalizuar, si edhe në seancën dëgjimore në Këshill, magjistratja ka deklaruar se vijonte të kishte marrëdhënie me disa kolegë dhe me disa të tjerë vetëm komunikim institucional.

43. KLGj-ja ka vendosur masën disiplinore sipas parashikimeve të nenit 115, pika 2, e ligjit nr. 96/2016, duke pasur parasysh kriteret: a) duhet të arsyetojë parimin e proporcionalitetit; b) duhet të marrë parasysh çdo rrethanë lehtësuese ose rënduese.

44. Në përfundim të shqyrtimit të procedimit disiplinor ndaj magjistrates dhe me konstatimin e përgjegjësisë së saj, nga ana e Këshillit është kryer jo në mënyrë abstrakte, por me referencë specifike ndaj të gjitha rrethanave në rastin konkret, një vlerësim i mirëfillt i proporcionalitetit midis faktit të ngarkuar dhe sanksionit që duhet të jepet. Në këtë vlerësim janë marrë parasysh, në radhë të parë, rëndësia e fakteve në raport me përmasën e tyre objektive; në radhë të dytë, natyra dhe intensiteti i elementit psikologjik në sjelljen e kontestuar, së bashku me motivet që e kanë shtyrë; dhe, së fundmi, personaliteti i magjistratit, veçanërisht në lidhje me aktivitetin e mëparshëm profesional dhe ndonjë precedent disiplinor.

45. Në caktimin e llojit të masës disiplinore në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara në nenin 115, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2016, janë mbajtur në konsideratë: i. ndaj magjistrates nuk rezulton të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore; ii. shkelja e kryer ka pasur një ndikim në një rreth të kufizuar personash, pasi në sallën e gjyqit, në seancën e datës 11.9.2024, kanë qenë prezentë vetëm përfaqësuesi i organit të akuzës dhe mbrojtësi, nuk ka pasur subjekte të tjerë, si i pandehuri, viktimë apo trashëgimtarët e tij, si dhe pjesëmarrës nga publiku; iii. magjistratja ka kërkuar ndjesë dhe ka pranuar faktin që sjellja e saj nuk ka qenë në përputhje me etikën dhe se ajo nuk duhet të kishte atë sjellje në prezencë të palëve; iv. magjistratja është në vitin e parë të punës dhe se ajo ka mungesë eksperience në gjykimin e çështjeve me trup gjykues, pasi vetëm dy çështjet objekt hetimi disiplinor kanë qenë të vetmet që ajo ka gjykuar deri më datë 11.9.2024.

46. Ligji nr. 96/2016, në nenet 106 dhe 107 të tij, parashikon se masat disiplinore që Këshilli mund të japë kur shkelja është konsideruar si e lehtë janë: “Vërejtje konfidenciale”, e cila jepet për shkelje të lehta, në të cilat publiku nuk është përfshirë ose nuk është vënë në dijeni të shkeljes (neni

106, pika 3) dhe “Vërejtje publike”, e cila jepet për shkelje të lehta, të cilat janë bërë publike (neni 107, pika 3).

47. Sikurse ka rezultuar nga hetimi disiplinor i zhvilluar, shkelja disiplinore ka ndodhur gjatë zhvillimit të një seance gjyqësore publike, në prani të palëve. Në këto kushte, duke pasur parasysh rëndësinë e shkeljes konkrete, në respektim të parimit të individualizimit dhe proporcionalitetit, Këshilli ka çmuar se masa disiplinore “Vërejtje publike” është masa më e përshtatshme, por edhe e mjaftueshme për të përmbushur qëllimin edukues të një magjistrateje të sapoemëruar në detyrë, me qëllim parandalues që kjo sjellje të mos përsëritet në të ardhmen nga magjistratja subjekt procedimi disiplinor, por edhe nga magjistratë të tjerë.

III. Prapësimet e ILD-së, lidhur me pretendimet e magjistrates Ajshe Xhafa

48. *Lidhur me pretendimin se nuk provohen me “mjaftueshmëri” faktet tipike dhe lidhja e tyre individuale me magjistratin:*

48.1 Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pretendimi i ngritur në ankim nga ankuesja, nuk qëndron, pasi, në kuadër të hetimit dhe procedimit disiplinor, janë kryer në mënyrë shteruese të gjitha veprimet hetimore të nevojshme për të konkluduar mbi ekzistencën ose jo të shkeljes disiplinore, për të cilën është kërkuar fillimi i procedimit disiplinor ndaj magjistrates Ajshe Xhafa.

48.2 Kërkesa për procedimin disiplinor ndaj magjistrates dhe vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor për pranimin e kësaj kërkesë, janë rezultat i vlerësimit në tërësi të fakteve dhe provave të administruara në procedimin disiplinor, marrja në pyetje e magjistratëve dhe punonjësve të tjerë të gjykatës që kanë dijeni për rrethanat e hetimit disiplinor, marrja në pyetje e vetë magjistrates Ajshe Xhafa, si dhe administrimi i provave shkresore të pakundërshtueshme, sikurse janë procesverbalet e seancave gjyqësore.

48.3 Magjistratja nuk ka respektuar rregullat e etikës dhe sjelljes profesionale, për më tepër gjatë ushtrimit të detyrës në seancë gjyqësore, gjatë gjykimit me dyer të hapura dhe në prezencë të palëve procedurale. Nga hetimi, ka rezultuar e provuar se gjyqtarja Ajshe Xhafa ka shkelur rregullat e sjelljes së gjyqtarit në sallën e gjyqit dhe ka vënë në dyshim jo vetëm integritetin dhe paanësinë e dy gjyqtareve të tjera, pjesë e trupës gjyqësore, por edhe të gjykatës në tërësi.

48.4 Magjistratja, Ajshe Xhafa, ka shkelur rëndë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes që duhet të karakterizojnë një gjyqtare, duke përdorur më shumë se një herë gjatë një seance gjyqësore publike, në prezencë të palëve, një retorikë të papërshtatshme në raport me funksionin e gjyqtarit, duke cenuar integritetin dhe ulur reputacionin e gjykatës, dhe duke konsumuar në këtë mënyrë elementet e shkeljes disiplinore që ka të bëjë me sjelljen joetike të parashikuar nenin 101, pika 1 dhe në nenin 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

49. *Lidhur me pretendimet se episodi i seancës gjyqësore të datës 11.9.2024, lidhet drejtpërdrejt me një kërkesë procedurale për shtyrje dhe njohje me aktet, pa deklarime publike dhe tejçim jashtë sallës së gjyqit, autoriteti kolegjial nuk u cënuar në rezultat dhe nuk u krijua ndikim i papranueshëm mbi paanësinë institucionale, nuk provohet pasojë e dëmshme në proces apo jehonë përtej rrethit të ngushtë të të pranishmëve. Masa e vërejtjes publike bazohet në një procesverbal të njëanshëm të sekretarit, ndërkohë që citimet audio janë përdorur të fragmentuara.*

49.1 Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, magjistratja nuk ka treguar kujdesin e duhur për të ruajtur standardin e gjyqtarës së përgjegjshme dhe profesionale, edhe pse ka pasur mundësinë që të zgjidhte të bënte një sjellje dinjitoze për të mos cenuar integritetin e gjykatës.

49.2 Gjyqtarja nuk është mjaftuar vetëm me kërkesën për shtyrje me qëllim njohjen me aktet, por ajo ka vijuar retorikën me dy gjyqtaret e tjera në sallën e gjykimit. Mënyra e sjelljes dhe retorika e përdorur më shumë se një herë, tregon se ajo nuk e ka ushtruar detyrën e gjyqtarës me

vetëpërmbytje, maturi dhe kujdesin e duhur që duhet të karakterizojë një magjistrat gjatë ushtrimit të detyrës.

49.3 Edhe në pamundësi objektive për njohjen me aktet, dhe në rastin më të keq, nëse nuk do t'i ishte vënë në dispozicion dosja, magjistratja, gjyqtare Ajshe Xhafa, duhej të shmangte së shprehuri në sallën e gjyqit opinionet e saj personale, në lidhje me veprimtarinë e dy gjyqtarëve, pasi në këtë mënyrë ka rrezikuar të përçojë te palët përshtypjen se gjykata është duke ndërmarrë një qasje të njëanshme dhe që palët të mos kenë besim që do të zhvillohet një proces i rregullt ligjor.

50. Lidhur me pretendimin se përdorimi si një rrethanë rënduese i një episodi nga një çështje tjetër, tejkalon objektin e procedimit të njoftuar dhe cenon parimin e akuzës dhe së drejtës për mbrojtje:

50.1 Në zbatim të nenit 123, pika 3, shkronja “dh”, nenit 129, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, magjistrates i është njoftuar vendimi i ILD-së nr. 2448/2 prot., datë 15.10.2024, “Për fillimin e procedimit disiplinor”, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 101, pika 1 dhe 102, pika 2, shkronja “dh” e po të njëjtit ligj.

50.2 Magjistratja ka marrë dijeni për hetimin disiplinor, të drejtat dhe detyrimet e subjektit të hetimit dhe, referuar përmbytjes së këtij vendimi, kuptohet se objekti i hetimit ka qenë edhe veprimtaria e magjistrates në drejtim të administrimit të dy dosjeve gjyqësore, si dhe ka dhënë shpjegime në lidhje me të dyja çështjet, si gjatë fazës së hetimit disiplinor të zhvilluar nga ILD-ja, dhe gjatë procesit disiplinor të zhvilluar pranë KLGj-së.

51. Lidhur me pretendimin se edhe nëse vlerësohet se gjuha e përdorur më datë 11.9.2024, meriton një vërejtje metodologjike, proporcionaliteti nuk është arsyetuar:

51.1 Referuar parashikimeve të nenit 110, të ligjit nr. 96/2016, parimi i proporcionalitetit është një prej parimeve që përshkon fazën e hetimit dhe procedimit disiplinor. Parashikimi i tij në mënyrë specifike i shërben garantimit të respektimit të procesit të rregullt ligjor, në funksion të caktimit ndaj magjistratit të një mase disiplinore që është në përpjesëtim me nivelin e shkeljes disiplinore të kryer dhe pasojave të ardhura.

51.2 Sipas ILD-së, pretendimi i ankueses se rrethanat lehtësuese imponojnë masa më të lehta sesa “Vërejte publike”, si dhe këshillimi etik ose vërejtje konfidenciale, jo me vërejtje publike, nuk qëndron.

51.3 Ndryshe nga sa pretendon ankuesja, në caktimin e llojit të masës disiplinore, janë marrë në konsideratë, si dhe janë analizuar kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes, parimi i proporcionalitetit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara në nenin 115, të ligjit nr. 96/2016.

51.3.1 Në rastin konkret, janë vlerësuar si rrethana lehtësuese: i. kryerja e shkeljes për herë të parë, duke qenë se nuk ka masë të mëparshme disiplinore; ii. ka pranuar se sjellja e saj në seancën gjyqësore publike të datës 11.9.2024, nuk ka qenë në përputhje me etikën dhe se nuk duhet ta kishte bërë atë sjellje në prani të palëve procedurale; iii. fakti që ka qenë magjistrate e emëruar më datë 12.10.2023 dhe nuk ka pasur eksperiencë profesionale.

51.3.2 Ndërsa, si rrethana rënduese, janë vlerësuar: i. shkelja është kryer në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve procedurale; ii. sjellja ka qenë në mënyrë të vazhdueshme, gjatë të gjithë seancës; iii. marrëdhënia e magjistrates me dy koleget e saj, anëtare të së njëjtës trupë gjykuese, nuk ka qenë e stabilizuar.

51.4 Në analizë të kriteve që lidhen me llojin dhe rrethanat e shkeljes, pasojat e shkeljes, shkallën e fajësisë dhe motiveve, rezulton se masa disiplinore më e përshtatshme, por edhe e

mjaftueshme për të përmbushur qëllimin edukues të një magjistrateje të sapoemëruar në detyrë, por edhe qëllimin parandalues që kjo sjellje të mos përsëritet në të ardhmen nga vetë magjistratja, por edhe nga magjistratët e tjerë, është pikërisht masa disiplinore “Vërejtje publike”.

52. *Lidhur me pretendimin se rrethanat lehtësuese imponojnë një masë më të lehtë disiplinore, sikurse mund të jetë “Vërejtje konfidenciale”:*

52.1 Në referim të nenit 106, pika 3, e ligjit nr. 96/2016, parashikohet se: “Vërejtje konfidenciale jepet për shkelje të lehta, në të cilat publiku nuk është i përfshirë ose nuk është vënë në dijeni të shkeljes”. Në rastin konkret, nga hetimi ka rezultuar se shkelja ka ndodhur gjatë një seance gjyqësore publike, në prezencë të palëve procedurale.

53. Hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe procedimi disiplinor i kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor janë realizuar në përputhje të plotë me parimin kushtetues të procesit të rregullt ligjor. Gjatë procesit disiplinor janë respektuar në tërësi parimet që udhëheqin këtë proces, të sanksionuara nga neni 100, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

54. Magjistratja Ajshe Xhafa, me veprimet/mosveprimet e saj, ka kryer shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 101, pika 1, shkronja “a” dhe neni 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Për legjitimitimin e ankuesit

55. Juridiksioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është një juridiksion kushtetues, i cili do të shoqërojë veprimtarinë e tij gjatë mandatit 9-vjeçar, sipas parashikimeve të nenit 179, pika 7, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon: “*Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë Drejtësisë. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*”.

56. Në vijim të këtij parashikimi kushtetues, neni 5, pika 3, shkronja “b”, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i përcakton Kolegjit të Posaçëm të Apelimit bazën ligjore mbi të cilën do të procedojë gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues, që lidhet me Juridiksionin Disiplinor, konkretisht: *Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: [...] b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*

57. Çështja e legjitimitimit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2 e Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8577/2000”), çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

58. Ankimi kushtetues individual duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

59. Në çështjen objekt shqyrtimi, lidhur me legjitimitimin e ankuesit, Kolegji vlerëson se ankuesja Ajshe Xhafa legjitimohet *ratione personae*, pasi vendimi i KLGj-së, të cilin e ka ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, është marrë në kuadrin e një procedimi disiplinor ndaj saj dhe, për pasojë, ankuesja ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

60. Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” e Kushtetutës, konstatohet se neni 100, pika 1, e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikon se vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve ankimohen në Gjykatën Kushtetuese. Bazuar në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, juridiksionin disiplinor kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjatë mandatit 9-vjeçar, e ushtron Kolegji i Posaçëm të Apelimit. Pra, ankuesja nuk ka mjet tjetër ligjor ankimi, përveç atij drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

60.1 Ankuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i KLGj-së që ankimohet, është i datës 2.4.2025¹⁴, ndërsa ankimi i magjistrates Ajshe Xhafa është protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit më datë 3.11.2025 dhe është regjistruar në të njëjtën datë, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, e ligjit nr. 8577/2000.

60.2 Për sa i takon legjitimitit *ratione materiae*, Kolegji çmon se pretendimet e ankueses ndaj vendimit nr. 190, datë 2.4.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë pretendime që *prima facie* hyjnë në juridiksionin disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe do të shqyrtohen në vijim.

B. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit

61. Në vlerësim të shkaqeve të ankimit të magjistrates Ajshe Xhafa, kundër vendimit nr. 190, datë 2.4.2025, të KLGj-së, Kolegji, pasi shqyrtoi aktet e administruara në fashikullin e çështjes së juridiksionit disiplinor nr. 3/2025, datë 3.11.2025, konstaton dhe vlerëson si vijon.

62. Kolegji vlerëson se, në kuadër të hetimit dhe procedimit disiplinor ndaj magjistrates, ILD-ja dhe KLGj-ja kanë kryer të gjitha veprimet hetimore për konkludimin mbi ekzistencën ose jo të shkeljes disiplinore ndaj magjistrates, si dhe procedurat për caktimin e masës disiplinore, në përputhje me parimet e procedimit disiplinor të parashikuara në nenin 100, pika 1, e ligjit nr. 96/2016. Parashikimet kushtetuese dhe ato ligjore përcaktojnë në mënyrë të ndarë fazat e procesit disiplinor ndaj gjyqtarëve, të hetimit disiplinor, i cili realizohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe të procedimit disiplinor, i cili shqyrtohet dhe vendoset nga Këshilli, si një organ vendimmarrës kolektiv.

63. Nga aktet që dokumentojnë marrjen e vendimit të KLGj-së, konstatohet se magjistratja Ajshe Xhafa është vënë në dijeni se ajo do të jetë pjesë e trupit gjykues për gjykimin e çështjes penale me nr. {***}, që në datën 29.7.2024, datë në të cilën është zhvilluar shorti. Kolegji vëren se, nga kjo datë deri në datën e planifikuar për gjykimin e kësaj çështjeje penale, 11.9.2024, magjistratja ka pasur kohën e nevojshme për t’u njohur me aktet e dosjes penale dhe marrjen e të gjitha masave jo vetëm për përgatitjen e saj për gjykimin e çështjes penale, por edhe për shmangien e shtyrjes së seancës gjyqësore, qoftë edhe në eventualitetin e pamundësisë për t’u njohur me aktet e dosjes kur ato iu vunë në dispozicion nga sekretari gjyqësor.

64. Deklarimet në seancën gjyqësore publike, replika me kryesuesen e trupit gjykues, si dhe relatimet në seancë, lidhur me pamundësinë e saj për t’u njohur me aktet e dosjes penale në gjykim,

¹⁴ Njoftuar magjistrates, me shkresën e KLGj-së nr. {***} prot., datë 1.7.2025, marrë dijeni më datë 4.7.2025, sipas vullës së Zyrës Postare Qendër, Kukës.

si dhe të një tjetër çështjeje penale, sipas përmbajtjes së procesverbalit gjyqësor të zhvillimit të seancës publike të datës 11.9.2024, të pasqyruara në pjesën hyrëse të vendimit, bien në kundërshtim me rregullat e etikës dhe sjelljes profesionale të magistrates dhe, aq më tepër, kur është duke ushtruar detyrën e gjyqtarit në një seancë gjyqësore, gjatë gjykimit me dyer të hapura, në prezencë të palëve.

65. Pretendimi i ankuseses, se nuk i është krijuar mundësia të njëjtoj me dosjen para seancës gjyqësore publike, duke kundërshtuar në këtë mënyrë edhe procesverbalin e mbajtur nga sekretari për dokumentimin e vënies në dispozicion të fashikujve të çështjes penale, çmohet pa efekt në analizimin nga Kolegji të sjelljes së saj, e cila vlerësohet e papranueshme dhe me pasojë cenimin e integritetit profesional të magistrates dhe, mbi të gjitha, të vetë gjykatës. Kjo sjellje dhe retorikë e saj në një seancë gjyqësore publike vlerësohet si e tillë, pavarësisht faktit nëse magistratja ishte objektivisht e justifikuar në mosnjohjen e dosjes penale për gjykim.

66. Konstatimi nga Kolegji i sjelljes dhe retorikës së përdorur nga ankuesja në sallën e gjyqit, gjatë një gjykimi në seancë publike dhe në mënyrë të përsëritur, tregon se ajo, përveçse nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtare me vetëpërmbajtje, maturi dhe kujdesin e duhur që duhet ta karakterizojë një magistrat gjatë ushtrimit të detyrës, ka cenuar edhe solemnitetin e procesit gjyqësor, sjellje kjo në cenim të vlerave themelore dhe standardeve të etikës dhe rregullat e sjelljes, të përcaktuara në nenet 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2026 dhe aktet ndërkombëtare lidhur me to.

67. Rezultoi, gjithashtu, e provuar se gjyqtarja Ajshe Xhafa ka shkelur rregullat e sjelljes së gjyqtarit në sallë të gjyqit, duke vënë në dyshim integritetin dhe paanësinë e dy gjyqtareve të tjera, pjesë e trupit gjykues. Sipas Kodit të Etikës Gjyqësore¹⁵: *Gjyqtari duhet të ruajë dhe të zbatojë standarde të larta të sjelljes dhe duhet t'i respektojë personalisht këto standarde, në mënyrë që integriteti dhe pavarësia të ruhen*¹⁶. Qëndrimi i shfaqur në seancën gjyqësore të datës 11.9.2024, nga magistratja, përbën rrezik që të përçojë te palët përshtypjen se gjykata, dy gjyqtaret e tjera, janë duke ndërmarrë një qasje të njëanshme dhe që palët të humbasin besimin në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor¹⁷.

68. Parimet e Bangalores të Sjelljes së Gjyqësorit – Kompetenca dhe Kujdesi, përcaktojnë se: *“Veprimtaria gjyqësore ka përparësi kundrejt çdo veprimtarie tjetër. Një gjyqtar do t'i përkushtohet veprimtarisë së tij gjyqësore, e cila përfshin jo vetëm performancën e funksioneve gjyqësore dhe përgjegjësinë në marrjen e vendimeve, por edhe funksione të tjera me rëndësi për funksionet gjyqësore ose për veprimtarinë e gjykatës. Një gjyqtar do të kryejë hapa të arsyeshëm për të ruajtur dhe zhvilluar aftësitë profesionale, njohuritë dhe cilësitë njerëzore të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave, duke përfutur nga trajnimet dhe lehtësira të tjera që do t'i ofrohen, nën kontrollin gjyqësor. Një gjyqtar do jetë i informuar mbi zhvillimet e rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë konventat ndërkombëtare dhe instrumente të tjerë në fushën e të drejtave të njeriut. Një gjyqtar do t'i kryejë të gjitha detyrat e tij, duke përfshirë vendimet,*

¹⁵ Miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 171, datë 22.4.2021, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 66, datë 29.4.2021.

¹⁶ Kodi i Etikës Gjyqësore, “Dispozita të përgjithshme”, pika 3 e tij.

¹⁷ Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 49, datë 10.7.2015, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “[...] gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëjës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet”.

eficiencën, drejtësinë dhe respektimin e afateve. Një gjyqtar do të mbajë rend dhe qetësi në sallën e gjyqit dhe do të jetë i duruar, dinjitoz në marrëdhëniet me palët, të miturit, dëshmitarët, avokatët dhe të tjerët me të cilët ai ndërvepron për shkak të funksionit të tij. Gjyqtari do të kërkojë sjellje të ngjashme edhe nga ana e përfaqësuesve ligjor, personeli i gjykatës dhe personat e tjerë nën ndikimin, autoritetin dhe kontrollin e gjyqtarit. Një gjyqtar nuk do të përfshihet në sjellje të papajtueshme me përgjegjësinë dhe kujdesin në kryerjen e funksioneve gjyqësore.”.

69. Në analizë të situatës faktike, si më sipër konstatuar dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi, Kolegji vlerëson se, ndryshe nga sa pretendon ankuesja/magjistratja, elementet e shkeljes disiplinore të parashikuar në nenin 101, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 102, pika 2, shkronja “dh”, e ligjit nr. 96/2016, rezultuan të provuara gjatë procedimit disiplinor.

70. Në shqyrtim të pretendimit të ankuses mbi cenimin e procesit të rregullt ligjor, standardit të arsytimit të vendimit të KLGj-së, si dhe të parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” të caktuar ndaj saj, Kolegji vlerëson se ky pretendim është i pabazuar, konkluzion ky i mbështetur në një analizë të hollësishme të procedurave të ndjekura nga ILD-ja gjatë hetimit disiplinor dhe nga KLGj-ja gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor, deri në caktimin e masës disiplinore ndaj ankuses, gjatë të cilit nuk u konstatuan shkelje me pasojë cenimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor.

71. Përkundër nga sa pretendon ankuesja, Kolegji vlerëson se KLGj-ja, në përcaktimin e rëndësisë së shkeljes dhe caktimit të masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj saj, rezulton të ketë mbajtur në konsideratë dhe të ketë analizuar hollësisht kriteret e nenit 115, të ligjit nr. 96/2016.

72. Në vlerësim të rëndësisë së shkeljes disiplinore dhe llojit të masës disiplinore, rezultoi se KLGj-ja ka marrë parasysh: llojin dhe rrethanat e shkeljes; shkallën e fajësisë dhe motivin; pasojat e shkeljes; të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratëve; masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore; çdo rrethanë të lidhur me gjendjen shëndetësore të magjistratit; rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit; sjelljen e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit; sjelljen e magjistratit gjatë procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij; çdo çështje tjetër që Këshilli i konsideron të rëndësishme.

73. Në analizë të kriterëve të parashikuara në nenin 115, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, konkretisht atë lidhur me natyrën dhe rrethanat e shkeljes, rezulton se ankuesja/magjistratja, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, ka shkelur normat e sjelljes ndaj magjistratëve të tjerë pjesëmarrës në trupin gjykues në seancën gjyqësore të datës 11.9.2024, veprime të cilat janë kryer gjatë një seance gjyqësore publike, në prani të përfaqësuesit të organit të akuzës dhe mbrojtësit të të pandehurit dhe, për shkak të rëndësisë së tyre, këto shkelje nuk lidhen me aspektet e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, por përbëjnë sjellje që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore.

74. Sa i përket kriterit që ka të bëjë me shkallën e fajësisë dhe motivin, ankuesja/magjistratja e ka kryer shkeljen disiplinore me dashje të drejtpërdrejtë, pasi kjo provohet nga deklaratimet e saj gjatë hetimit disiplinor, nga provat e administruara gjatë shqyrtimit të procedimit në KLGj dhe nga shpjegimet e palëve, nëpërmjet parashtrimeve të paraqitura prej tyre, në kuadër të shqyrtimit të ankimit të ankuses Ajshe Xhafa.

74.1 Lidhur me analizën e kriterit mbi pasojat e shkeljes, vlerësohet se sjellja e ankuses Ajshe Xhafa, veçanërisht e një gjyqtareje në sallën e gjyqit, ka rëndësi jo vetëm në planin profesional të gjyqtarës, në integritetin e procesit gjyqësor dhe në drejtin të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë. Në përputhje me Parimet e *Bangalores* për sjelljen gjyqësore, cenimi i normave etike, qoftë në marrëdhëniet e punës apo jashtë tyre, mund të ndikojë negativisht në besimin e publikut ndaj sistemit të drejtësisë. Në rastin konkret, sjellja e saj ka vënë në dyshim paanësinë e dy

kolegeve gjyqtareve para palëve ndërgjyqëse – kjo konsiderohet si cenim i parimit të besimit të palëve të pranishme te drejtësia, si dhe diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit, duke cenuar integritetin dhe reputacionin e gjykatës.

74.2 Në kuadër të kriterit *që lidhet me të dhënat profesionale, disiplinore dhe penale të magjistratit*, rezulton se ankuesja është emëruar gjyqtare me vendimin nr. 552, datë 12.10.2023, të KLGj-së dhe nuk ka ende vlerësime etiko-profesionale, si dhe ndaj saj nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë disiplinore.

74.3 Në analizën e kriterit për *masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore*, rezulton, nga aktet e dosjes, si dhe shpjegimet e ankueses, se marrëdhënia e saj me dy gjyqtaret e tjera nuk është normalizuar ende, gjë që mund të krijojë premisa për sjellje të tjera të papërshtatshme në të ardhmen dhe, rrjedhimisht, paraqet rrezik real për dëmtimin e imazhit të gjykatës.

74.4 Në lidhje me kriterin *e rrethanave të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit*, konstatohet se edhe gjatë hetimit disiplinor nga ILD-ja, ashtu edhe gjatë shqyrtimit në KLGj, nuk rezultuan të dhëna apo rrethana të asaj natyre që të kishin ndikim në vlerësimin e çështjes.

74.5 Në analizën e kriterit në lidhje *me sjelljen e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas nisjes së hetimit*, vlerësohet se ankuesja/magjistratja ka treguar bashkëpunim, pasi: i. ka paraqitur shpjegimet e saj pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është paraqitur për t’u pyetur kur është kërkuar dhe ka pranuar faktet, duke shpjeguar arsyet e sjelljes së saj; ii. ka kërkuar ndjesë dhe ka pranuar se veprimi i saj nuk ishte në përputhje me normat etike dhe se nuk duhej të ishte kryer në prani të palëve; iii. në perceptimin e saj, dy gjyqtaret kanë mbajtur qëndrim tendencioz ndaj saj që nga fillimi i ushtrimit të detyrës në gjykatë.

74.6 Në kuadër të kriterit që lidhet *me sjelljen e magjistratit gjatë procedimit disiplinor dhe qëndrimin ndaj tij*, rezulton se ajo ka bashkëpunuar me ILD-në dhe KLGj-në, duke dorëzuar parashtrimet brenda afateve ligjore¹⁸ dhe duke marrë pjesë në seancën dëgjimore.

74.7 Në analizë të kriterit *mbi rrethanat apo çështje të tjera që Këshilli i konsideron të rëndësishme për çështjen*, rezulton se gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në KLGj, e pyetur se si do të vepronte në të ardhmen nëse do të kishte këto shqetësime të ngjashme, ankuesja/magjistratja ka deklaruar se vijonte të kishte marrëdhënie me disa kolegë, ndërsa me disa të tjerë komunikim vetëm institucional.

75. Kolegji konstaton se KLGj-ja, në vendosjen e masës disiplinore, ka marrë në analizë edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese, sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2, 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2016, në përputhje me parimin e proporcionalitetit për efekt të caktimit të masës disiplinore të përshtatshme, të domosdoshme dhe të balancuar në raport me shkeljen e konstatuar.

76. Në vijim të analizës si më sipër, Kolegji vlerëson se, në rastin konkret, janë vlerësuar si rrethana lehtësuese: i. kryerja e shkeljes për herë të parë, duke qenë se nuk ka masë të mëparshme disiplinore; ii. ka pranuar se sjellja e saj në seancën gjyqësore publike të datës 11.9.2024, nuk ka qenë në përputhje me etikën dhe se nuk duhet ta kishte bërë atë sjellje në prani të palëve procedurale; iii. fakti që ka qenë magjistrate e emëruar më datë 12.10.2023 dhe nuk ka pasur eksperiencë profesionale.

77. Ndërsa, si rrethana rënduese, janë vlerësuar: i. shkelja është kryer në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve procedurale; ii. sjellja ka qenë në mënyrë të vazhdueshme, gjatë të gjithë seancës; iii. marrëdhënia e magjistrates me dy koleget e saj, anëtare të së njëjtës trupë gjykuese, nuk ka qenë e stabilizuar.

¹⁸ Dorëzuar parashtrime nga ankuesja Ajshe Xhafa në datën 12.11.2024, pranë ILD-së dhe në datën 17.3.2025, pranë KLGj-së.

78. Ligji për Statusin, në nenet 106, 107, parashikon se masat disiplinore që Këshilli mund të japë, kur shkelja disiplinore është konsideruar si e lehtë, janë “Vërejtje konfidenciale” dhe “Vërejtje publike”.

79. Në nenin 106, pika 3, e ligjit nr. 96/2016, parashikohet se: “Vërejtje konfidenciale jepet për shkelje të lehta, në të cilat publiku nuk është i përfshirë ose nuk është vënë në dijeni të shkeljes”. Ndërsa, neni 107, pika 3 e po këtij ligji parashikon se: “Vërejtje publike jepet për shkelje të lehta, të cilat janë bërë publike”.

80. Rezultoi e provuar nga aktet se shkelja disiplinore ka ndodhur gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore publike të datës 11.9.2024, të një çështjeje penale, në prani të palëve, prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit. Në këto kushte, duke pasur parasysh rëndësinë e shkeljes konkrete, në respektim të parimit të proporcionalitetit, Kolegji vlerëson se masa disiplinore “Vërejtje publike” është masa më e përshtatshme, por edhe e mjaftueshme për të përmbushur qëllimin edukues të ankueses/magjistrates Ajshe Xhafa, të sapoemëruar në detyrë, me qëllimin parandalues që kjo sjellje të mos përsëritet në të ardhmen prej saj, por edhe nga magjistratë të tjerë.

81. Pretendimi i ankueses se rrethanat lehtësuese imponojnë një masë më të lehtë disiplinore “Vërejtje konfidenciale”, për shkak se publiku nuk është i përfshirë, se në seancë gjyqësore ishin prezentë vetëm prokurori dhe mbrojtësi i të pandehurit, ndaj ndikimi është i kufizuar vetëm në dy persona, në rastin konkret nuk qëndron, pasi nga hetimi disiplinor dhe shpjegimet e parashtruara në Kolegji nga vetë ankuesja, ka rezultuar se shkelja disiplinore ka ndodhur gjatë një seance gjyqësore publike dhe në prezencë të palëve procedurale. Bazuar në nenin 106, pika 3, e ligjit nr. 96/2016, “Vërejtja konfidenciale” jepet për shkelje të lehta, në të cilat publiku nuk është i përfshirë ose nuk është vënë në dijeni të shkeljes.

82. Në këto kushte, Kolegji i Posaçëm i Apelimit arrin në përfundimin se shkeljet disiplinore të magjistrates, të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, të konstatuara nga ILD-ja dhe të shqyrtuara dhe vlerësuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në procedimin disiplinor ndaj saj, janë të tilla që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore dhe se masa disiplinore e vërejtjes publike, e dhënë ndaj magjistrates nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, është proporcionale me rëndësinë e shkeljeve të kryera prej saj.

83. Për sa më sipër, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në analizën në tërësi të pretendimeve të ankueses, çmon se vendimi nr. 190, datë 2.4.2025, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është i drejtë, i bazuar në fakte e në ligj, dhe kërkesa e magjistrates Ajshe Xhafa nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” e Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Mospranimin e ankimit të magjistrates Ajshe Xhafa kundër vendimit 190, datë 2.4.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktimin e masës disiplinore ‘Vërejtja publike’ ndaj magjistrates Ajshe Xhafa, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 25.5.2026.
Shpallur më 16.6.2026.

Kryetar: Sokol Çomo

Gjyqtarë: Rezarta Schuetz, Ina Rama, Mimoza Tasi, Natasha Mulaj, Albana Shtylla